



GARA SHKETËRORE NGA
SHKENCAT NATYRORE

PËR KLASËN E V

përgjigjet

(07.qershor 2026)

1. Dy popullacione të së njëjtës specie, të shënuara me A dhe B, janë vëzhguar gjatë një viti dhe ndryshimi i numrit të individëve të tyre është regjistruar me kujdes. Në fillim të vëzhgimit, numri i individëve në popullacionin A ishte 50, ndërsa numri i individëve në popullacionin B ishte 100. Të dhënat për natalitetin (B), mortalitetin (D), imigrimin (I) dhe emigrimin (E) për të dyja popullacionet gjatë periudhës së vëzhgimit janë dhënë në tabelën më poshtë.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme!

	Popullacioni A	Popullacioni B
Numri i individëve të lindur (B)	15	37
Numri i individëve të ngordhur (D)	11	23
Numri i individëve që janë imigruar (janë vendosur në popullatë) (I)	20	6
Numri i individëve që janë emigruar (janë larguar nga popullata) (E)	9	5

- I) Gjatë periudhës njëvjeçare të vëzhgimit të të dyja popullacioneve, në cilën popullacion (popullatë) ka pasur ndryshim më të madh në numrin e individëve? (2 pikë)

Ndryshimi në numrin e individëve është i njëjtë në të dyja popullatat.

- II) Në fund të periudhës njëvjeçare të vëzhgimit: (1 pikë)

a) Të dyja popullacionet (popullatat) e vëzhguara ishin me numër të njetë.

b) Numri i individëve në popullatën A ishte më i madh se numri i individëve në popullacionin (popullatë) B.

c) Numri i individëve në popullatën B ishte më i madh se numri i individëve në popullacionin (popullatë) A.

3/ _

2. Lexoje tekstin dhe rretho **S** nëse pohimi në lidhje me tekstin është i saktë, ose **J** nëse pohimi është i pasaktë.

Bulkthi i dheut (insekt) dhe urithi evropian (gjitar) janë specie që jetojnë në të njëjtin mjedis tokësor dhe bëjnë jetë nëntokësore. Në këmbët (gjymtyrët) e tyre të përparme ndodhen struktura në formë kthettrash, të përshtatura për gjermimin e tokës. Të dyja speciet e gjejnë ushqimin në tokë, ku ushqehen me insekte, krimba toke dhe larva, ndërsa krimbi i tokës ushqehet edhe me rrënjë bimësh.


Në lidhje me habitatin që e përdorin, të dy llojet janë në marrëdhënie konkurruese.	S	J
Krimbi i tokës dhe urithi evropian kanë të njëjtin përshtatje sepse janë të afërt (të lidhur) në prejardhje.	S	J
Krimbi i tokës dhe urithi evropian kanë shikim të mirë.	S	J
Të dyja speciet i përkasin të njëjtës popullatë.	S	J

4/ _

3. Lexoje me kujdes tekstin dhe paraqit marrëdhëniet trofike (ushqimore) midis specieve (llojeve) të përmendura.

Në numrin më të fundit të një reviste profesionale që lidhet me kopshtarinë, një kopshtar ka shkruar: “Ndër speciet që unë i konsideroj të dëmshme dhe që jetojnë në trëndafilat e mi, më shpesh gjej afide (morrat e bimëve), me të cilat mund të ushqehen mollëkuqet (nusekalikuset) dhe milingonat. Merimangat mund të ushqehen me mollëkuqet. Qukapikët nga pylli përreth mund të ushqehen me larvat e milingonave, si dhe me individët e rritur të tyre, ndërsa zogjtë sikë ushqehen me merimanga. Është thënë diku se zogjtë grabitqarë qëndrojnë në majë të piramidës trofike të kësaj bashkësie.”

Bazuar në tregimin e kopshtarit, në çdo fushë shkruaj emrin e organizmit të gjallë që i përket.



8/_

4. Marko dhe Vedrana përgatitën një tretësirë të ngopur të sheqerit në ujë të ngrohtë. Çfarë do të ndodhë nëse këtë tretësirë e ftoh në temperaturë dhome?

a) Do të kristalizohet teprica e substancës së ngurtë.

b) Tretësira do të bëhet e pangopur, sepse tretshmëria e sheqerit zvogëlohet me uljen e temperaturës.

c) Tretësira do të bëhet e pangopur, sepse tretshmëria e sheqerit rritet me uljen e temperaturës.

d) Nuk do të formohen kristale, sepse sheqeri i tretur gjithmonë mbetet i tretur në ujë pavarësisht temperaturës.

1/_

5. Për secilën nga opsionet e dhëna A–DH, në fushën përkatëse në anën e djathtë të termit vendos një nga numrat 1, 2 ose 3, dhe atë:

1 nëse bëhet fjalë për një përzierje homogjene

2 nëse bëhet fjalë për një përzierje heterogjene

3 nëse bëhet fjalë për një komponent të pastër, përkatësisht një substancë e pastër

Për shembull:

uthull	1
--------	---

A) bronz	1
B) çaj i kulluar (i filtruar)	1
C) mjegull	2
Ç) ari	3
D) stiropor	2
DH) minerali i boksitit	2

6/_

6. Cili/cilat nga pohimet e mëposhtme janë të sakta? Zgjidh një nga opsionet A, B, C ose D.

- i. Nëse piperi në formë kokrrash bluhet në pluhur, ai do të tretet më shpejt në një vëllim të caktuar uji.
- ii. Tretshmëria e kripës në një vëllim të caktuar uji do të rritet nëse në vend të kripës së trashë përdoret kripë e bluar (pluhur).
- iii. Gjatë përgatitjes së një tretësire të sodës së bukës në ujë, procesi i tretjes mund të përshpejtohet me përzierje.

A) vetëm i

B) ii и iii


C) vetëm iii

D) i, ii и iii

2/_

7. Në figurë është paraqitur aparatura për një procedurë për ndarjen e përbërësve të një përzierjeje. Filtrati është shënuar me shkronjën:

- a) A
- b) B
- c) C**
- d) Ç
- e) D



1/_

8. Renditni vendet e shënuara sipas sasisë së pritur të reshjeve, duke filluar nga I (sasia më e vogël) deri në V (sasia më e madhe). Mbani mend se relievi ndikon në klimë!




Përgjigje:

1	2	3	4	5
III	V	I	II	IV


5/_

9. Gjatë një ore në shkencat e natyrës, ku mësohej për madhësinë e hijeve të objekteve, mësuesja u dha një grupi nxënësish detyrën e treguar në figurën më poshtë.

Nxënësve iu dha një mollë që e vendosën ndërmjet burimit të dritës dhe murit, ashtu që hija e mollës në fillim ishte 5 cm e lartë. Burimi i dritës u vendos në një bankë më largë dhe nuk lëvizte fare. Detyra konsistonte në lëvizjen e mollës drejt murit nga nxënësit dhe ta matnin madhësinë e hijes.



Ata bënë pesë matje të ndryshme të cilat i paraqitën në grafikun e mëposhtëm dhe i lidhën me një vijë ato:



Por, meqenëse tavolina e tyre ishte shumë e vogël për të matur distanca më të mëdha, mësuesja i pyeti nxënësit a mundën duke përdorur grafikun të bëjnë parashikime. Në çfarë distance duhet të vendoset molla në mënyrë që hija të jetë:

a) dy herë më e lartë se hija fillestare? 3 m (2 pikë)

b) 6 cm e lartë? 1,4 m (1 pikë)

c) 1,6 herë më e lartë se hija fillestare? 2,2 m (nëse shkruajnë që hija duhet të jetë 8 cm e lartë, jepen 2 pikë) (3 pikë)

10. a) Renditni oqeanet sipas madhësisë, duke vendosur një numër nga 1 (më i vogli) deri në 5 (më i madhi) pranë secilit emër: (5 pikë)

- Oqeani Arktik - 1
- Oqeani Indian - 3
- Oqeani Atlantik - 4
- Oqeani Paqësor - 5
- Oqeani Antarktik - 2

b) Duke ditur vendndodhjen e oqeanëve dhe brezave të nxehtësisë (termikë) të Tokës, te cilët oqeanë ka më shumë rryma detare të ftohta sesa të ngrohta? (4 pikë)

Arktik (Verior akullnajë) dhe Antarktik (Jugor); secila përgjigje mbart 2 pikë _____

11. Syzet e diellit që të gjithë i mbajmë gjatë verës për të mbrojtur sytë nga rrezet e forta të diellit kanë xhama (qelqe) me nuanca të ndryshme ngjyrë gri (përhimët). Cilat nga përgjigjet e mëposhtme janë të sakta?

a) xhamat e tyre janë lyer me material jo të tejdukshëm

b) sa më e errët të jetë nuanca e ngjyrës gri, syzat lejojnë aq më pak dritë të kalojnë

c) syzat e diellit bëhen prej xhami transparent


d) asnjë nga më sipër

12. Cili është shkaku i tërmeteëve gjatë shpërthimeve (erupsioneve) vullkanike?

lëvizja e magmës nga rezervuari i saj drejt kanaleve vullkanike – 2 pikë

(çdo përgjigje që përfshin lëvizjen e magmës vlerësohet me një pikë)

13. Cila formë relievi krijohet nga lëvizja e pllakave tektonike të paraqitura në figurë?



Përgjigje:

mal (pranohet edhe breg, mal dhe kodër) - 2 pikë

përgjigjet: vullkan, relief vullkanik, rrafshnaltë - me 1 pikë

2/_